



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazës

Nr. 11-729
Br.

Data 01.06.2023
Datum

OBILIQI - OBILIC

Memorandum i Mirëkuptimit:

i lidhur në mes:

- Komuna e Obiliqit**, si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e themeluar në pajtim me Ligjet dhe Kushtetutën e vendit dhe ushtron detyrat dhe përgjegjësit e saj në pajtim me ligjin për Qeverisje Lokale dhe legjislacionin tjetër në fuqi, për interes të përgjithshëm të qytetareve të saj dhe komunitetit në përgjithësi, e përfaqësuar ligjërisht nga Kryetari i Komunës, z. Xhafer Gashi, (me tutje në tekst Komuna e Obiliqit)
- Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 36**, si ndërmarrje publike qendrore e rregulluar në bazë të ligjit për ndërmarrje publike, me aksionar të vetëm Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ndërmarrje kryesore për prodhimin energjisë elektrike, e përfaqësuar ligjërisht nga zyrtari kryesor i Komunitetit të Përgjithshëm të Përpunimit të Energjisë Elektrike, z. Përparim Kabashi (me tutje në tekst KEK)

Lidhin këtë Memorandum të Mirëkuptimit:

1. Qëllimi i memorandumit

Qëllimi i Memorandumit është bashkëpunimi i ndërsjellë në funksion të përmirësimit të mirëqenies së komunitetit në zonën e Obiliqit, dhe ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të KEK në zonën e komunës konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, licencës së operimit dhe në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-044 Për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth Tij.

Në pajtim me këtë, Komuna e Obiliqit dhe KEK pajtohen për bashkëpunim në çështje të interesit të ndërsjellë:

- 1.1. Zbatimit i projekteve të propozuara nga komuna për përfitim të komunitetit
- 1.2. Zgjidhja e problemit të infrastrukturës rrugore në zonën e operimeve të KEK-ut, në veçanti të rrugës në Sibovc dhe fshatrat përreth, që janë ndikuar nga projektet e shpronësimit për zgjerimin e minierave;
- 1.3. Bashkëpunimi në zgjidhjen e çështjes së deponimeve të mbetjeve inerte, caktimi i lokacionit dhe përkrahja me makinerinë e rëndë;
- 1.4. Ndhimja e ndërsjelle në zbatimin e projektit të Parku Solar (100MW) në ish-deponin e hirit të TC-A dhe lëshimin i pëlqimeve mjedisore për të cilat Komuna është përgjegjëse dhe kërkohet ndihma për lejet në nivelin qendrorë;
- 1.5. Rregullimi i çështjes së bartjes dhe regjistrimit të pronave të shpronësuara në aparatin kadastral komunal si dhe ofrimi i të gjithë dokumentacionit pronësor për projektet e KEK për përvetësim të tokës dhe zgjerim të minierës;
- 1.6. Ndhimja rreth projektit ngrohjes qendrore (a.q. ko-gjenerim) për Komunën e Obiliqit;
- 1.7. Caktimi i lokacionit për zhvendosjen e varrezave të lagjes Krasniqi dhe ndihma e ndërsjellë;



1.8. Vazhdimi i projektit të brezit të sigurisë nga Instituti i Mjekësisë së Punës deri te hyrja 01 – DPO;

2. Legjislacioni në fuqi,

Bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe duke pasur parasysh se Ndërmarrjet Publike Qendrore, janë në pronësi të Republikës së Kosovës, e cila në nivel Qendror udhëhiqet nga Qeveria e vendit, ndërsa në nivel lokal, nga ana e pushtetit lokal, Kuvendi Komunal. Lidhur me këtë, një zgjidhje bashkëpunimi dhe bashkërendimi duhet të gjendet pa pasur nevojë aplikimin e procedurave të shpronësimit për shkak se kemi të bëjmë me të mirën e përbashkët publike.

Gjithashtu projektligji për pronën publike miratuar në mbledhjen e 85- të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 02/85 të datës 22.01.2019, i cili parashihet të miratohet nga Kuvendi do të rregulloj edhe transferimet e pronësisë nga niveli qendror tek ai lokal dhe anasjelltas lidhur me implementimin e projekteve.

Deri në miratimin e këtij ligji palët nuk do të ndërhyjnë dhe nuk do të merren me pronësinë, por si qëllim të përbashkët e kanë bashkëpunimin me qëllim të implementimit e projekteve të nevojshme dhe domosdoshme për njëra tjetrën e të cilat nuk mund të finalizohen pa koordinim dhe pajtim të ndërsjellë.

3. Obligimet e palëve:

3.1. Për Projektet e komunitetit palët obligohen si në vijim:

- a) Komuna obligohet të sjellë propozim projektet më së largu në fund të muajit Shtator për vitin e ardhshëm.
- b) KEK (komisioni) do ti shqyrtojë dhe përzgjedh projektet të cilat do të paraqiten gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.
- c) KEK do ti procedojë projektet e komunitetit jo më larg se në përfundim të kuartalit të parë të vitit vijues.
- d) Komuna të caktojë një monitorues të procesit në të gjitha fazat deri në përfundim i cili po ashtu do të jetë edhe përgjegjës që të raportojë me shkrim për ecurinë e kësaj procedurë apo dështimit eventual (duke përfshi shkaqet) në Komune.
- e) Në rast se projektet e kontraktuara nuk realizohen brenda vitit fiskal për arsye të ndryshme, KEK-u mjetet të cilat mbesin t'i bart në vitin vijues pa ndikuar në mjetet që do të ndahen për projektet e planifikuara për vitin tjetër.

3.2. Për çështjen e rrugëve lidhëse brenda zonës së operimeve të KEK - rruga në fsh. Sibovc dhe fshatrat për rreth, KEK dhe Komuna obligohen që të formojnë grupet punuese të cilat do të gjejnë një zgjidhje për rrugët alternative, është dakorduar që propozimi final të jetë rruganga Bregovinët të lidhet me Rr. "Afrim Krasniqi" (te varrezat e Nicëve) afati sa më parë.

3.3. Për çështjen e bashkëpunimit në zgjidhjen e deponimeve të mbetjeve inerte, KEK ka propozuar lokacione ri në pjesën Jugore të palosjes së brendshme ku disniveli është mbi 20m dhe, për këtë qëllim, Komuna dhe KEK (Divizioni i Prodimit të Qymyrit) të caktojnë nga një zyrtarë përgjegjës të cilët do të dakordohen për modalitetet e operimeve në teren si dhe çështjeve të sigurisë gjatë hyrje/daljeve të makinerive.

3.4. Parku solar - për projektin solar 100MW në ish deponin e hirit të TC-A

Komuna obligohet për pajisje me lejet e nevojshme si:

- Pëlqimi komunal
- Përfshirja e projektit në Hartën Zonale Komunale HZK

3.5. Shpronësimet dhe regjistrimi i pronave në aparatën kadastral - kërkohet përkrahje e komunës.

Sa i përket disa pronave për të cilat banorët nuk janë pajtuar me PVZH / KPZH, si zhvendosje vullnetare, dhe të njëjtat në fazën tjetër i janë nënshtruar ligjit të shpronësimit, për të cilat ka edhe vendim të Qeverisë, ato prona po regjistrohen në emër të QRKS përkundër që janë kompensuar nga KEK-u. Për këtë arsye kërkohet ndihma e Komunës që të njëjtat të barten në emër të KEK sh.a. ose si kompromis në emër të KEK sh.a. – Qeveria e Republikës së Kosovës.

3.6. Projekti i ko gjenerimit (ngrohja qendrore) për Komunën e Obiliqit.

KEK ka në dispozicion kapacitetin prej 280 MWh energji termike, me ndërtimin e stacionit aktual (në vitin 2014) të ko-gjenerimit shfrytëzohen 140 MWh energji termike të cilat i janë ndarë NP Termokos-it bazuar në marrëveshjen (nr 252, dt 24.12.2014) për furnizim me ngrohje.

KEK ka në dispozicion edhe 140 MWh energji termike nëse nga palët e interesit ndërtohet stacioni i ri.

Duke u bazuar në paragrafin 3.2 të nenit 8 të Ligjin Nr. 05/L-044 Për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth Tij, komunës së Obiliqit, KEK në parim pajtohet që t'i sigurohet qasje në energjinë termike (avullin që del nga turbinat), duke u bazuar në nevojat e komunës së Obiliqit. Lidhur me këtë, do të lidhet marrëveshje e veçantë mes palëve pasi të jenë plotësuar kushtet ligjore.

3.7. Caktimi i lokacionit për zhvendosjen e varrezave të lagjes Krasniqi.

Komuna obligohet ta caktojë lokacionin për zhvendosjen e varrezave të lagjes Krasniqi. (Komuna tashmë ka caktuar lokacionin dhe do të ndihmojë në procesin e implementimit)

3.8. Vazhdimi i projektit të brezit të sigurisë nga Instituti i Mjekësisë së Punës deri te hyrja 01 - DPQ.

KEK obligohet të vazhdojë projektin e brezit të gjelbër nga IMP deri te hyrja 01 DPQ dhe të nënshkruaj memorandumin e mirëkuptimit (apo aneksin e MM paraparak) me Komunën e Obiliqit që kjo e fundit të vazhdojë me shtegun e udhëtareve dhe shtegun e biçikletave në këtë segment.

Mëqëllim të implementimit të dy projekteve reciproke, palët do të caktojnë ekip të përbashkët të përberë nga gjeodetët të cilët bashkërisht do të hartojnë elaboratin gjeodezik i cili do të përcaktojë lëvizjen e rrethojës aktuale në funksion të implementimit të dy projekteve, dhe për projektin në fjalë KEK-u merr përsipër që hapësirën e cekur më lart ta mbush me dhe (djerrinë) sipas nevojës, ndërsa komuna do ta realizoj projektin e mbjelldhjes së drunjëve.

Të dy palët pajtohen që për të caktuar dhe saktësuar lëvizjen e rrethojës kufizuese.

Të dy palët pajtohen bashkërisht që të ndihmojnë dhe lehtësojnë punën e njëratjetrësme qëllim të implementimit të projekteve dhe të dy palët bashkërisht do të eliminojnë dhe minimizojnë dëmet eventuale për njëra tjetrën dhe për palët e treta eventualisht.

4. Hyrja në fuqi e Memorandumit:

Memorandumi i përbashkët hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do të zbatohet nga palët deri në implementimin e plotë dhe përfundimtarë të projekteve, dhe secila palë do të marrë përsipër shpenzimet vetanake.

Për KEK-sha
Përparim Kabashi

zv. Kryeshef Ekzekutiv (u.d.) KEK

Datë:

01/06/2023



Për KK. Obiliq,
Xhafer Gashi
Kryetar i Komunës - Obiliq

Datë:

01/06/2023

